



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Mrugë të reja të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Kosovës. Nënshkruhet në Prizren Kalendarit Kulturor Shqipëri- Kosovë 2018

2018-06-18 12:06:00



Ministrat e Kulturës, Mirela Kumbaro Furxhi dhe Kujtim Gashi dakordësojnë kalendarin kulturor Shqipëri- Kosovë në Prizren, cilësuar si 'kryeqyteti' historik i kombit shqiptar. "Kultura është hapësira jonë e përbashkët, pa kufij, kultura dëshmon më së miri se nuk ka kufi tjetër mes Kosovës dhe Shqipërisë përveç atyre administrativë,"- u shpreh Ministrja Kumbaro në ceremoninë e nënshkrimit. Në 140-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit dhe në Vitin Mbarëkombëtar të

Skënderbeut, Ministrja e Kulturës së Republikës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro Furxhi dhe Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit i Republikës së Kosovës, Kujtim Gashi nënshkruan sot në ambientet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Protokollin e Bashkëpunimit për Kalendarin e Përbashkët Kulturor 2018.

Ministrat e Kulturës, Mirela Kumbaro Furxhi dhe Kujtim Gashi dakordësojnë kalendarin kulturor Shqipëri- Kosovë në Prizren, cilësuar si 'kryeqyteti' historik i kombit shqiptar.

"Kultura është hapësira jonë e përbashkët, pa kufij, kultura dëshmon më së miri se nuk ka kufi tjetër mes Kosovës dhe Shqipërisë përveç atyre administrativë,"- u shpreh Ministrja Kumbaro në ceremoninë e nënshkrimit.

Në 140-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit dhe në Vitin Mbarëkombëtar të Skënderbeut, Ministrja e Kulturës së Republikës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro Furxhi dhe Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit i Republikës së Kosovës, Kujtim Gashi nënshkruan sot në ambientet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Protokollin e Bashkëpunimit për Kalendarin e Përbashkët Kulturor 2018.

Ministri Kujtim Gashi e cilësoi nënshkrimin e kalendarit si një ditë të rëndësishme për të dy vendet. "Është ditë shumë e veçantë për Kosovën dhe Shqipërinë. Nënshkrimin e kalendarit vjetor kulturor e kemi ideuar në lokacion të veçantë në shtëpinë tonë të përbashkët. Ky akt hap rrugë të reja të bashkëpunimit mes Kosovës dhe Shqipërisë", u shpreh ai.

Protokolli i Bashkëpunimit, i cili nënshkruhet për të pestin vit radhazi cilëson se përmes këtij akti, dy vendet janë pajtuar për përfshirjen e aktiviteteve kulturore në një kalendar të përbashkët, i cili është i bazuar në "Deklaratën e përbashkët për bashkëpunim dhe partneritet strategjik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës" nënshkruar në Prizren më datë 11 janar 2014.

Kalendarit i përbashkët kulturor Shqipëri- Kosovë 2018 dakordëson aktivitete në fushën e trashëgimisë, që kanë të bëjnë me digjitalizimin e trashëgimisë dhe trajnime e edukim në fushën e restaurimit dhe konservimit; ekspozita në fushën e arkeologjisë dhe të muzeve; pjesëmarrje e Kosovës në Festivalin Mbarëkombëtar të Teatrit, që do të mbahet në Tiranë; projeksione të premierave të pesë filmave, bashkëprodhime të dy qendrave të filmit; AQSHF do të realizojë premierën e filmit pa zë "Balkan Wars", shoqëruar me muzikë 'live' nga artisti kosovar Adorel Haxhiaj; bashkëpunime në fushën e librit, mes qendrave të fëmijëve, etj. Një ekspozitë e artistes Flaka Haliti do të sjellë në GKA veprat e saj bashkëkohore duke shënuar edhe ekspozitën e parë personale të saj në Shqipëri. Ministrja Mirela Kumbaro Furxhi theksoi se "Ky kalendar është

formalizim i një bashkëpunimi dhe komunikimi kulturor, ne angazhohemi si institucione përgjegjëse për të hartuar bashkëpunimin, por merita për realizimin e aktiviteteve artistike iu shkon njerëzve të kulturës, si atyre të institucioneve publike, ashtu edhe atyre të skenës së pavarur”.

Të dy ministrat nënvizuan se bashkëpunimi në art e kulturë ka nisur muaj më parë më parë, siç ishte ekspozita me objekte të rëndësishme të Isa Boletinit, apo pjesëmarrja e të dy Qendrave të Filmit në Kanë e Berlin, etj.

“Mendoj që ky është një moment që dy institucionet tona janë në krye të organizimeve, duke mos ndërhyrë në pjesën e pavarur të institucioneve të kulturës”- u shpreh Gashi ndërsa shfaqti para medias edhe vlerësim për punën e ministres Kumbaro në raport me lobimin për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO.

Ministrja Kumbaro vlerësoi skenën e pavarur të Kosovës duke u shprehur se “Ne kemi njohur energjinë që ka skena e pavarur e Kosovës me të cilën duam të kemi një bashkëpunim, por edhe për të mësuar më shumë sepse skena e pavarur në Tiranë nuk e ka të njëjtën pjekuri si në Kosovë. Në konceptim tim kultura është si lumenjtë, lumenjtë kur kalojnë vijën e ujit nga një vend në tjetrin, nuk pyesin nëse ka kufi dhe as që kanë pasaportë për ta treguar, kështu që unë gjykoj që ne duhet të krijojmë të njëjtin mjedis komunikimi për kulturën, për t’iu lejuar artistëve tanë të zgjerojnë audiencat e tyre“, tha ajo.

Të dy ministrat nënvizuan se koncepti i kalendarit të përbashkët është i hapur dhe në të do të përfshihen edhe të gjitha vendet ku ka shqiptarë.

“Koncepti i kalendarit të përbashkët kulturor është për të krijuar një skenë të hapur me Maqedoninë, me Malin e Zi, padyshim edhe me Greqinë por jo vetëm”- tha në fund ministrja Kumbaro.